

AKT THEMELIMI I SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"FiberPrints" Sh.p.k.

Sot me date 27 shtator 2022, une i nenshkruari Z. Arsen Hadroj, shtetas Amerikan, i lindur në Shqipëri më 06.11.1984, mbajtës i pasaportës me nr: 664400318, kam vendosur te nënshkruaj Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (me poshte "Shoqeria"), aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

Neni 1 - Emertimi

Emërtimi i Shoqërisë është "FiberPrints" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është Rruga "Cerciz Topulli", pallati Evisa ShpK, Kati 3, Ap.2 Tiranë, Shqipëri

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4 – Objekti i shoqerise


4.1 Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

4.1 Ne menyre me specifike, Shoqeria do te kryeje aktivitet tregtar:

- Studimit, projektimit, zbatimit, supervizionit te projekteve dhe te zbatimit te objekteve ndertimore, konsulencave inxhinierike ne fushen e ndertimit, konsulence ne strukturat e inxhinierise civile, arkitektures, studimeve urbanistike dhe ambjentale, projekteve teknologjike, sherbime inxhinierike, menaxhim projektesh, planifikim strategjik, studime tregu. Projektim dhe zbatim te rrjeteve inxhinierike. Import-eksport mallrash dhe sherbimesh. Shit-blerje sherbimesh dhe mallrash.

Aktiviteti i firmes do kete shtrirje nderkombetare.

Shoqeria ka te drejte te kryeje gjithashtu cdo lloj aktiviteti tjeter te lejuar nga ligji Shqiptar.



Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 Leke (njqind Leke).
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqerise përbëhet nga 1 (një) kuote, me vlere nominale 100 Leke (njqind Leke).

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise është ofruar si me poshtë:

-Ortaku Z. Arsen Hadroj, shtetas Amerikan, i lindur në Shqiperi më 06.11.1984, mbajtës i pasaportës me nr: 664400318, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 100 Leke (njqind Leke)

6.2 Sipas kontributeve te mësipërme:

-Ortakut Z. Arsen Hadroj i përket 1 (një) kuote, qe i korrespondon me 100% (njqind përqind) te kapitalit te Shoqerise.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.


Neni 8 – Administrimi

8.1 Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator i Shoqerise personi si me poshte:

- Z. Admir Hadroj, shtetas shqiptarë, i lindur në Dedaj më 27.01.1987, mbajtës i letërnjoftimit me nr: 033298444 dhe nr personal I70127055V.

8.2 Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 95 te ligjit nr. 9901, date 14 prill 2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe nenit 14 te Statutit.

8.3 Administratorit i jepet te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer te gjitha formalitetet per permbushjen e detyrimeve te parashikuara per themelimin e Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Per



kete qellim, Administratoret, mund t'u drejtohen per ndihme te treteve ose konsulenteve te cileve mund te delegojne ne teresi ose pjeserisht kryrjen e aktivitetit te siperpermendur.

8.4 Administratori eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise per formim e deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ai eshte gjithashtu i autorizuar, te firmosi te gjitha aktet dhe te marre persiper detyrime ne emer te Shoqerise qe rrjedhin prej momentit te regjistrimit te saj si edhe ka te drejte t'i delegoje kompetencat e tyre personave te tjere.

Neni 9- Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Z. Arsen Hadroj

Arsen Hadroj
